




MINISTRIA  
E SHËNDETËSISË



FRUTHI DHE  
VAKSINA MMR


PËRGJIGJE NË PYETJET  
MË TË SHPESHTA




## Çfarë është fruthi dhe kush është i rrezikuar?

Fruthi është sëmundje shumë ngjitëse e shkaktuar nga një virus, e cila mund të shkaktojë komplikime serioze, madje edhe vdekje.

Fruthi mund të prekë këdo që nuk është imun, por më së shpeshti shfaqet tek fëmijët. Është veçanërisht i rrezikshëm për fëmijët e vegjël nën moshën 5 vjeç, gratë shtatzëna dhe personat me sistem imunitar të dobësuar.




## Si përhapet fruthi dhe sa ngjitës është?



Fruthi përhapet lehtësisht kur një person i infektuar kollitet ose teshtin. Personat e tjerë mund të infektohen nëse thithin ajrin e kontaminuar ose prekin një sipërfaqe të infektuar dhe më pas prekin sytë, hundën ose gojën.

Virusi mund të mbijetojë deri në 2 orë në ajër ose në sipërfaqe.



Fruthi është jashtëzakonisht ngjitës: rreth 90% e personave që nuk janë imun dhe që bien në kontakt me një të infektuar, do të infektohen. Një person mund ta përhapë virusin edhe para shfaqjes së simptomave.

## Cilat janë simptomat e para të fruthit?

Simptomat zakonisht shfaqen 7–14 ditë pas ekspozimit ndaj virusit dhe përfshijnë:

- temperaturë të lartë
- kollë
- rrjedhje të hundës
- sy të skuqur dhe të përlotur



Skuqja karakteristike e fruthit (ekzantema ose njolla të kuqe) shfaqet 3–5 ditë pas simptomave të para. Ajo fillon zakonisht në fytyrë, pranë vijës së flokëve, dhe më pas përhapet në qafë, trup, krahë, këmbë dhe shputa.

## Sa serioz është fruthi?

Fruthi është një sëmundje serioze dhe shumë ngjitëse. Nuk është thjesht një sëmundje e lehtë e fëmijërisë.

Sipas të dhënave të OBSH-së dhe UNICEF-it, mbi gjysma e të infektuarve me fruth në rajonin e Evropës gjatë viteve të fundit kanë kërkuar hospitalizim.

Komplikimet janë më të shpeshta tek fëmijët nën 5 vjeç. Një në pesë fëmijë të infektuar mund të zhvillojë komplikime të rënda.

## Cilat janë komplikimet më të zakonshme?

Komplikimet mund të përfshijnë:

- verbërim
- encefalit (infeksion i trurit që mund të shkaktojë dëmtime të përhershme)
- diarre (barkqitje) të rëndë dhe dehidrim
- infeksione të veshit që mund të çojnë në dëmtim të të dëgjuarit
- pneumoni dhe probleme të rënda të frymëmarrjes

Në vendet me të ardhura të mesme dhe të larta, 1–2 në 1,000 raste përfundojnë me vdekje, ndërsa 1 në 1,000 zhvillon encefalit.

Fruthi poashtu dobëson sistemin imunitar, duke e bërë organizmin më të ndjeshëm ndaj sëmundjeve të tjera për muaj apo edhe vite.

## Si mund ta mbrojt fëmijën tim?

E vetmja mënyrë efektive për të parandaluar fruthin është vaksinimi.

## Sa efektive është vakcina kundër fruthit?

Vaksina MMR kundër fruthit dhe dy sëmundjeve të tjera – shytave dhe rubellës – është shumë efektive. Një dozë e vetme e vaksinës MMR ofron mbi 90% mbrojtje në parandalimin e fruthit. Pas dozës së dytë, mbrojtja rritet në rreth 97–99%.



## Kur duhet ta vaksinoj fëmijën tim kundër fruthit?

Sipas kalendarit të rregullt të vaksinimit në Kosovë, doza e parë e vaksinës MMR jepet në moshën 12 muaj, ndërsa doza e dytë në moshën 5–6 vjeç.



## A është vakcina e sigurt?

Po. Në Kosovë vakcina MMR është në përdorim prej më shumë se 50 vitesh, ndërsa globalisht ka filluar të administrohet që nga viti 1971 dhe është studiuar gjerësisht.

Efektet anësore janë zakonisht të lehta dhe të përkohshme, si:

- skuqje ose ënjtje në vendin e injektimit
- temperaturë e lehtë.

## A shkakton vakcina autizëm?

Jo. Nuk ka asnjë provë shkencore që lidh vaksinën MMR me autizmin. Studime të shumta, të cilat kanë përfshirë miliona fëmijë, kanë konfirmuar një gjë të tillë.

Shembuj të studimeve të fundit përfshijnë një [studim me më shumë se 650,000 fëmijë](#) (studim kombëtar “kohort” i realizuar në Danimarkë), i publikuar në vitin 2019, i cili nuk gjeti asnjë rritje të rrezikut për zhvillimin e autizmit te fëmijët që morën vaksinën MMR, krahasuar me fëmijët që nuk ishin vaksinuar kundër MMR, përfshirë edhe ata me histori familjare të autizmit ose faktorë të tjerë rreziku.

Gjithashtu, [një rishikim i madh studimesh](#) i publikuar në vitin 2021 analizoi sigurinë, efektivitetin dhe çdo efekt të padëshiruar nga vaksinimi MMR. Ai përfshiu 13 studime me rreth dy milionë fëmijë, duke shqyrtuar në mënyrë specifike rrezikun e autizmit, dhe këto studime nuk gjetën asnjë lidhje midis vaksinimit MMR dhe çrregullimeve të spektrit të autizmit.



Shumë fëmijë me çrregullime të spektrit të autizmit i shfaqin simptomat e para të dukshme për prindërit pas vitit të parë të jetës, periudhë që shpesh përkon me kohën kur rekomandohet doza e parë e vaksinës MMR. Kjo përputhje në kohë mund të krijojë një perceptim të gabuar të lidhjes mes vaksinës dhe autizmit.

### **Çfarë përmban vakcina MMR?**

Vaksina përmban viruse të dobësuara që nuk shkaktojnë sëmundje, por krijojnë imunitet të fortë dhe afatgjatë.

Vaksina MMR nuk ka përmbajtje të metaleve si merkuri ose alumini.

### **Çfarë është imuniteti i tufës/kolektiv dhe pse është i rëndësishëm?**

Kur rreth 95% e popullatës është e vaksinuar, krijohet imuniteti kolektiv dhe sëmundja nuk përhapet. Kjo ndihmon në mbrojtjen edhe të atyre që nuk mund të vaksinohen, siç janë fëmijët nën moshën 1 vjeç ose ata që për arsye shëndetësore nuk mund të vaksinohen.

### A duhet të shtyhet vaksinimi?

Jo. Shtyrja e vaksinimit përtej kohës së rekomanduar në kalendarin e rregullt të vaksinimit rrit rrezikun që fëmija të infektohet, të zhvillojë komplikime nga sëmundja, si dhe ta përhapë infeksionin te fëmijët e tjerë.



### A mund të marrë fëmija vaksinën nëse është vonuar?

Po. Nuk është kurrë vonë për të marrë dozat e humbura të vaksinës kundër fruthit. Veçanërisht tani, kur kemi raste aktive të fruthit, është shumë e rëndësishme që fëmijët e pavaksinuar të vaksinohen sa më parë, para se të bien në kontakt me virusin.

IKShPK bën thirrje prindërve që të kontrollojnë kartelën e vaksinimit të fëmijëve të tyre dhe t'i vaksinojnë fëmijët në qendrën e vaksinimit më të afërt të Mjekësisë Familjare.

*Në partneritet me UNICEF në Kosovë.*